

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Kumbari' i grupeve të Dizdarit, Çopjave e Gjikës, arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/kumbari-i-grupeve-te-dizdarit-opjave-e-gjikes-arrestohet-ne-rusi-shpe-i47042
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:47:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 18:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ca4ba5b8f96581b0c56b657ff568c144f9640a40ef9ad31efa7843a5a7dc69a6
TEKSTI	c685d1125e243a0b3d8bb388119167e72141ab86dd1c6e569abef44cf7ee566c4
PAMJA	2df8145f426fa693963393361658b6b3aa596c3e90d795ac7ae7d83013544716

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d7783b3919c2f33e3f8e2af3d87374bf96dd56d0e357799db4cbf77161714f04
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d7783b3919c2f33e3f8e2af3d87374bf96dd56d0e357799db4cbf77161714f04>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

"Na kanë bërë shumë gjëra o shpirt"/ Vlera Hyseni dhe Ergys Agasi mbi 500 mesazhe në 2 muaj në Signal. Shefja e SHISH i dha materiale sekrete, merret në pyetje nesër në GJKKO!

23 Shtator 2026, 13:50

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 23 Shtator 2026, 20:21

‘Kumbari’ i grupeve të Dizdarit, Çopjave e Gjikës, arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu

Shpëtim Aliu konsiderohet "kumbari" i grupeve të trafikut të kokainës pasi grupet kriminale të drejtuara nga Dizdari, Çopjat apo Gjika ishin vartës të Aliut i cili kokainën e sillte nga Ekuadori.



Shkruar nga Versus



Shpëtim Aliu, një prej personave më të kërkuar nga drejtësia shqiptare, është arrestuar në Rusi. Aliu, i njohur edhe me aliasin “Salvatore”, është konsideruar nga SPAK si një prej figurave kryesore të një rrjeti të fuqishëm të trafikut ndërkombëtar të kokainës.

Sipas hetimeve të SPAK, Aliu dyshohet se kishte një rol drejtues në organizimin e trafikut të kokainës nga Amerika Latine drejt Europës. Në dosje, ai përshkruhet si personi që siguronte lëndën narkotike nga Ekuadori, ndërsa grupet kriminale të lidhura me Dritan Gjikën, grupin e Çopjave dhe persona të tjerë dyshohet se vepronin në varësi të këtij rrjeti.

SPAK lëshoi në muajin qershor urdhër-arreste për 10 persona, mes tyre edhe Shpëtim Aliun. Ai akuzohet për veprat penale “trafikimi i narkotikëve” dhe “pjesëmarrja në grup të strukturuar kriminal”.

Hetimet e Prokurorisë së Posaçme kanë dokumentuar veprimtarinë e grupit gjatë viteve 2019–2021 në Amerikën Latine, Brazil, Belgjikë dhe Holandë. Sipas SPAK, grupi dyshohet se ka trafikuar të paktën 50 tonë kokainë.



Arrestimi i Shpëtim Aliut në Rusi, policia: Operacion i përbashkët i Interpol Tiranës dhe Moskës, pritet ekstradimi i 51-vjeçarit

23 Shtator, 20:39

Në kuadër të hetimit janë dokumentuar pesë episode të trafikut të kokainës, ku autoritetet kanë sekuestruar në total 8 tonë e 960 kilogramë lëndë narkotike.

Në episodin e parë, më 11 maj 2020, 700 kilogramë kokainë u sekuestruan në portin e Waasland në Antverp të Belgjikës. Sasia ishte fshehur në një kontejner me pjesë këmbimi automjetesh, i cili kishte ardhur nga Kina.

Më 6 qershor 2020, në Guayaquil të Ekuadorit u sekuestruan 2 tonë e 10 kilogramë kokainë, e cila dyshohej se kishte destinacion final Holandën. Sipas hetimeve, lënda narkotike mbante tre logo të ndryshme: “Jaguar”, “Shqiponjë” dhe “BB”.

Më 16 gusht 2020, në Rotterdam të Holandës u sekuestruan 1.1 ton kokainë, e cila kishte mbërritur me anije nga porti i Guayaquil në Ekuador.

Në episodin e katërt, më 16 dhjetor 2020, autoritetet holandeze sekuestruan 4.1 tonë kokainë në portin e Roterdamit. Edhe kjo ngarkesë kishte ardhur nga porti i Guayaquil.

Episodi i pestë lidhet me datën 3 shkurt 2021, kur në Kolumbi u sekuestruan 1 ton e 50 kilogramë kokainë, e cila kishte si destinacion final Francën.

SPAK thotë se, përveç pesë episodeve të dokumentuara, anëtarët e grupit dyshohet se kanë trafikuar edhe dhjetëra tonelata të tjera kokainë nga Amerika Latine drejt vendeve europiane, duke siguruar të ardhura të konsiderueshme.

Pastrimi i parave, 491 pasuri nën sekuestro

Hetimet kanë nxjerrë në pah edhe një skemë të pastrimit të parave. Sipas SPAK, një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave nga trafiku i kokainës është futur në Shqipëri në formën “cash”, për të shmangur fillimisht sistemin bankar.

Më pas, paratë dyshohet se janë investuar në pasuri të paluajtshme, kompani dhe aktivitete në sektorë të ndryshëm, përfshirë ndërtimin, hotelierinë dhe konsulentë.

Sipas hetimeve, fondet janë qarkulluar edhe përmes huave mes personave fizikë dhe kompanive të lidhura, ndërsa dyshohet se janë përdorur blerje fiktive të kuotave të kapitalit dhe transaksione të tjera për të fshehur origjinën e parave.

Me kërkesë të SPAK, Gjykata e Posaçme ka vendosur më 15 qershor 2026 masën e sigurimit pasuror “sekuestro preventive” për 491 pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të personave nën hetim.

Në mesin e pasurive të sekuestruara janë prona dhe kuota kompanish në Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Fier, Hamallaj, Lezhë, Shkodër, Himarë dhe Sarandë.

Sipas SPAK, bëhet fjalë për 266 pasuri të paluajtshme, përfshirë toka, truall, hotele, apartamente dhe vende parkimi. Në listë përfshihen edhe 121 pasuri në kompleksin “Porto Lalzi/Lalzi Marina Seaside” në Hamallaj, struktura hotelierie në Dhërmi, prona në Qerret, Hotel “Elisa Tirana”, vila në komplekse rezidenciale në Tiranë dhe Durrës, si dhe apartamente, njësi tregtare dhe parkime në zona të ndryshme të kryeqytetit.

Gjithashtu janë sekuestruar automjete të ndryshme, mjete teknologjike për ndërtim, mjete transporti, autovetura dhe mjete lundruese, si dhe 209 llogari bankare që u përkasin personave fizikë e juridikë dhe personave të lidhur me ta.

Vlera totale e pasurive të sekuestruara dyshohet të jetë rreth 150 milionë euro, ndërsa SPAK ka bërë të ditur se gjatë hetimeve do të verifikohet vlera e saktë e tyre.

Pas arrestimit të Shpëtim Aliut në Rusi, pritet të ndiqen procedurat ligjore për vijimin e çështjes dhe ekstradimin e tij drejt Shqipërisë./Versus.al

Poll



AKTUALITET

[Akuzohet se trafikoi 50 ton drogë nga Ekuadori drejt Evropës, policia zbardh veprat penale të Shpëtim Aliut](#)

23 Shtator 2026, 20:32

^ekstrakti^



AKTUALITET

[“Presim sjellje të përgjegjshme shtetërore”, familjet e ish-krerëve të UÇK-së kërkojnë qëndrim të unifikuar ndaj vendimit të Hagës](#)

23 Shtator 2026, 20:14

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Të dielën ‘Tiranathlon’/ Ja rrugët ku do të kufizohet qarkullimi imjeteve dhe itinerari i linjave urbane](#)

23 Shtator 2026, 20:10

^ekstrakti^





AKTUALITET

Aksidenti i dytë brenda ditës në Durrës, makina përplas qytetarin me monopatinë

23 Shtator 2026, 19:32

^ekstrakti^



AKTUALITET

Kallas takime të ndara me Kurtin dhe Vuçiç në OKB: Progresi në dialogun Kosovë-Serbi, kusht për integrimin në BE!

23 Shtator 2026, 19:21

^ekstrakti^



AKTUALITET

Dy vatra zjarri në Vlorë dhe pranë liqenit të Viroit në Gjirokastrë. Era përhap flakët, digjen koshere me bletë

23 Shtator 2026, 19:04

^ekstrakti^



AKTUALITET

"Zegjine moj Zegjine...ti nuk di të numërosh", aktivistja "kap mat" socialisten në Bulevard. Ja si reagoi deputetja

23 Shtator 2026, 18:38

^ekstrakti^





AKTUALITET

["Në 2 muaj 70 telefonata, Agasi ia refuzoi 28 herë thirrjet"/ SPAK: Mes ish-shefes së SHISH dhe biznesmenit kishte dhe video-call](#)

23 Shtator 2026, 18:21

^ekstrakti^

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.